



ALBANËT

REVISTA



ALBANËT





QEVERIA E NXËNËSVE



Në shkollën “Albanët” si çdo vit tjetër, ashtu edhe këtë vit është zgjedhur qeveria e nxënësve me presidenten në krye. Të gjithë senatorët e klasave votuan për zgjedhjen e presidentes. Me shumicë votash u zgjodh presidente e shkollës “Albanët” Klaris Gjikhuri. Këtë vit u bë një përjashtim në lidhje me zgjedhjen e presidencës së shkollës, qeverisja u bë nga dy presidente Klaris Gjikhuri dhe Era Mulla.

Zv. president: Dionis Kacani.

Pjesëtarë të qeverisë janë edhe senatorët dhe zv. senatorët e çdo klase.

Kl. VI A: Senator Fabio Caka, zv. senatorët Dea Ruçi.

Kl. VI B: Senator Deni Muça, zv. senator Uendi Goga dhe Selma Dervishaj.

Kl. VII: Senator Klarida Ruka, zv. senator Rea Braksi.

Kl. VIII: Senator Jorkeid Hoxha, zv. senator Aleksio Gora.

Kl. IX: Senator Dejv Agara, zv. senator Anisa Muzhaqi dhe Sonja Shehu.

Ne, si qeveri, mundohemi t’i ndihmojmë nxënësit në çdo lloj aspekti. Ne mundohemi të ndihmojmë nxënësit në lidhje me mardhënien që ata kanë me mësuesit dhe me njëri-tjetrin. Deri tani ky hap i qeverisë ka shkuar shumë mirë dhe ka ndihmuar nxënësit në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin dhe me mësuesit.

Presidenca nuk ka mbaruar akoma së organizuari aktivitete në lidhje me shkollën .

Ne kemi në plan të zhvillojmë dy bamireshi për fëmijët në nevojë dhe ata me aftësi të kufizuara. Nëse nxënësit kanë dëshirë të tjera, ne jemi të gatshëm t’i pranojmë dhe të mundohemi t’i realizojmë.



Aktivitetet e zhvilluara nga presidenca e shkollës janë të bazuara në kërkesat e nxënësve të shkollës. Të gjithë pjesëtarët e qeverisë kanë qenë pjesëmarrës në aktivitetet e zhvilluara nga ne. Gjithashtu dhe nxënësit e shkollës kanë qenë të aktiv në këto aktivitete.

Si fillim pjesëtarët e qeverisë mblodhën libra e më pas rregulluan bibliotekën duke i ndarë librat në kategori të ndryshme. Tani të gjithë nxënësit e shkollës janë të lirë të marrin libra kur të dëshirojnë. Ky ishte hapi i parë që presidenca bëri për shkollën, pasi të lexuarit të librave është gjëja më e rëndësishme për ne nxënësit.

Pas përfundimit të bibliotekës unë dhe qeveria vendosëm të organizojmë një panair ushqimesh për të mblëdhur disa fonde. Panairi u pëlqye shumë nga të gjithë dhe u zhvillua për një javë. Fondet e mbledhura nga ky panair u dhanë përsëri të nxënësit në formë çmimesh tek “Albanët Got Talent 3”.

“Albanët Got Talent” është një talent show i cili ka nisur për herë të parë para 3 vitesh. Ky show ka qenë shumë i preferuar nga nxënësit, kështu që edhe ne këtë vit e organizuam këtë show ku të gjithë kishin mundësi të shfaqnin talentet e tyre. Ky talent show nxori 3 fitues, vendi i parë: Darlin Bineri, vendi i dytë Keina Zela dhe Ajla Bardhi dhe vendi i tretë: Klara Kovaçi.



JAVA E PROJEKTEVE

Java e projekteve në shkollën “Albanët” është një nga pikat më kryesore të saj, pasi nxënësit angazhohen, njihen me tema të reja dhe gjithashtu mësojnë nëpërmjet tyre se si të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

Gjithçka nis nga mbledhja e stafit në fund të qershorit, ku përcaktohen veprimtaritë për vitin e ardhshëm shkollor. Këto veprimtari pasqyrohen në kalendarin vjetor në fund të qershorit. Duke marrë parasysh orët vjetore që mësuesit kanë në dispozicion, përcaktohet se në sa ditë do të shtrihen projektet. Për përcaktimin e temave mblidhet përsëri stafi drejtues dhe në bazë të grupmoshës apo zhvillimeve që ndodhin përcaktohen temat. Pas kësaj, për ciklin e lartë ndahen nxënësit në grupe dhe hidhet shorti.



Në ciklin e ulët, fëmijët njihen me projektin dhe temën e tij. Më pas ata pyeten se sa njohuri kanë rreth kësaj teme. Pasi zbërthehet tema, vendoset qëllimi se për çfarë do të shërbej ajo. Fëmijët ndahen në grupe dhe marrin detyrat organizohen dhe më pas përgatisin postera, foto, video, makete, veprimtari praktike dhe dramatizime.



Disa prej temave që zhvillohen në këtë shkollë për projekte janë: “I duam dhe i mbrojmë kafshët”, “Bota e përrallave”, “Për ty” (nxënësit e klasave të dyta shkuan te qendra e fëmijëve me “Sindromën Dawn” dhe kuptuan se të gjithë fëmijët janë njëloj, pavarësisht ndryshimeve që kanë), “Pranvera”, “Gjuha e dashurisë” (nxënësit e klasave të IV-ta shkuan në fshatin Sos, u miqësuan me fëmijët që banonin atje dhe u premtuan se do të shkonin sërisht me prindërit e tyre), “Mendo para se të flasësh dhe vëre veten në vend të shokut”, “12 muaj të shëndetshëm”(nxënësit e klasave të V-ta mësuan se si të qëndronin 12 muaj të shëndetshëm duke ngrënë sa me shumë fruta, perime, ushqime e duke kryer veprimtari fizike)

“Bazat e komunikimit në pulik”,
 “Shkencat në gatim”, “Moti”,
 “Familja ime”, “Sfilata në duart tona”, “Qyteti ekologjik”

(nxënësit e klasave të IV-ta pas-truan lagjjen, bën shëtitje me biçikleta dhe mësuan shumë gjëra të reja e interesante).



Pas tri ditëve punë me projektet, dita e katërt është prezantimi i tyre pra në të cilin juria pjesëmarrëse vendos grupin fitues. Gjithmonë ditët e projekteve janë të mbushura plot emocion, gëzim dhe punë masive.





6

GJUHËT E HUAJA

Mësimi i shumë gjuhëve është mundësi praktike për komunikimin jashtë vendit ku jeton. Mësimi i gjuhëve të huaja duhet të fillojë që në moshë të vogël.

Në shkollën tonë fëmijët njihen me anglishten që në kopsht. Në fillim me këngë ose me aktivitete dhe më pas në klasë të parë ku fillojnë të hedhin bazat me libra për moshën e tyre.

Më pas në klasë të katërt fëmijëve ju jepet mundësia të mësojnë dhe një gjuhë të dytë. Ata mund të zgjedhin midis gjermanishtes, italishtes dhe frëngjishtes.

Kur fëmijët kanë vështirësi në këto gjuhë, mësuesit janë të gatshëm për t'i ndihmuar duke u bërë orë shtesë.

Në shkollën tonë janë bërë shumë aktivitete për gjuhët e huaja, si:

- “Dita e gjuhëve të huaja”,
- Olimpiada e anglishtes “Hippo”,
- “Java e Frankofonisë”
- Ditë specifike kur janë bërë punë praktike për gjermanishten, etj.



Disa objektiva të përgjithme të ditës evropiane të gjuhëve të huaja janë:

1. Të ndërgjegjësojë për rëndësine e të mësuarit të gjuhëve dhe të diversifikojë gjuhët e mësuara në mënyrë që të rritet shumë gjuhësia dhe të kuptuarit ndërkulturor.
2. Të promovojë diversitetin e pasur gjuhësor dhe kulturor të Evropës, i cili duhet të ruhet dhe forcohet.
3. Të inkurajojë të nxënit gjatë gjithë jetës, brenda dhe jashtë shkollës, për studime, nevoja profesionale, udhëtime për kënaqësi ose shkëmbime.



4. Të ndërgjegjësojë publikun për gjuhët e përdorura në të gjithë hapësirën evropiane
5. Të promovojë diversitetin kulturor dhe gjuhësor në këto vende
6. Të inkurajojë qytetarët, fëmijët e shkollave dhe të rriturit për të mësuar gjuhët e huaja.

Në këtë kontekst, do të theksohet fakti se diversiteti gjuhësor është një mjet për të krijuar një dimension ndërkulturor më të madh dhe një element kyç në trashëgiminë e pasur kulturore të Evropës.

Ese: “Klasa ime”

Familja ime e dytë! Klasa ime është vendi ku përballesh me një mjedis të ngrohtë, me nxënës që të mikpresin menjëherë dhe me mësues me një buzëqeshje të dashur në çdo moment. Klasa është e madhe dhe me dritë. Gjithashtu miqësia jonë e ndriçon çdo cast me dije e pozitivitet. E kjo me anë të diellit tonë, mësimdhënia e mësuesve tanë të mençur. Të gjithë këto elementë bëjnë që miqësia dhe dijet tona të rriten e të forcohen çdo ditë...

Klasa jonë është laborator kimie, sepse profesori ynë kujdestar është profesori i mrekullueshëm i kimisë dhe i biologjisë. Ne klasë kemi postera, punime dhe piktura me shumë cilësi, që tregojnë talentin tonë në çdo fushë. Faqen kryesore e zë tabela e re dhe e madhe ku shpegohet mësimi dhe ne zgjidhim ushtrimet, herë me ndrojtje, herë me shumë siguri. Pozicioni i bankës sime më jep mundësinë të shijoj mësimin e të rrethohem nga miq të mrekullueshëm. Tani për tani, në klasë jemi njëzet e një nxënës, dy prej të cilëve janë të rinj, ama po përshtaten më së miri.

Kjo përshtatje ndodh, sepse jemi tetë orë në ditë në komunikim të vazhdueshëm me njëri-tjetrin. Janë krijuar lidhje të forta, megjithëse unë kam vetëm 3 vite në shkollën “Albanët”. Në orën e pushimit e sidoms në drekë mblidhemi e bisedojmë për gjithçka që na vjen në mendje, për shaka të së kauarës e për ëndrrat e së ardhmes. Dreka në tavolinë me profesorin është familjare dhe e mbushur plot me batuta. Kemi filluar të mblidhemi për të festuar ditëlindjen e gjithsecilit e për të kaluar momente të paharrueshme.

Çdo mësues na thotë se mësimi në klasën tonë është ndryshe. Ata kur na shpjegojnë “qetësohen”, sepse ne jemi të rritur, i kuptojmë, i respektojmë dhe i duam shumë. Ama ka raste, kur disa prej nesh nuk kanë përmbushur kërkesat kryesore të mësuesve, prandaj thonë: “Shohim se po bëheni mendjemëdhenj!”- një fjali që na bën të ulim kokat të mërzhitur. Nga ana tjetër çdo orë që kalon me një shpjegim perfekt, karakteristik “Alban”, përfundon me të qeshura. Në fund të ditës, pasi kemi përvetsuar gjithçka që mundemi, skojmë në shtëpi me shumë energji positive.

Tik-takut të orës sonë tek “Albanët” po i vjen fundi, po afrohen provimet e lirimit. Kjo gjë shpesh na bën që të ndihemi melankolik për klasën, oborrin, mensën, sallën e kërcimit e korridoret e shkollës sonë. Kjo ndjenjë më shoqëron edhe në çastin kur mendoj që secili prej nesh do të marri drejtime në shkolla të ndryshme. Nga ana tjetër ky tik-tak na bën të shtojmë forcat për të arritur rezultatet e dëshiruara nga ne dhe mësuesit tanë. Ditët ikin njëra pas tjetrës, por ne jemi krenarë për çdo gjë që përjetojmë në shkollën “Albanët”, “sepse jam dhe do mbetem Alban”!!!

Andra Kota

“Historia jonë”

Dyshja fantastike dhe unike. Ne kemi marrëdhënien më të bukur në botë si motër e vëlla. Por gjithashtu e konsiderojmë njëri-tjetrin edhe si shok. Ne jemi **Rea** dhe **Marko**, nxënës në shkollën “Albanët”.

Kemi një vit e gjysmë diferencë (Marko është më i madh se unë), prandaj jemi rritur bashkë. Kemi shijuar fëmijërinë tonë në mënyrë perfekte me lojëra, këngë, filma e argëtime të tjera. Që të vegjël diskutonim për sekretet tona. Talentet i kemi të njëjta: piktura dhe kërcimi, prandaj në çdo gjë jemi së bashku. Zënkat kanë qenë gjithmonë të pranishme, megjithatë të qeshurat dhe dashuria për njëri-tjetrin kanë rikuperuar çdo gjë.

Nga ana tjetër ka momente që jemi vetëm, meqë tani jemi të rritur. Kur ndodhemi në shtëpi gatuajmë, zakonisht patate të shkëlqyera, por në fund grindemi se kush do t’i hajë... Pastaj shikojmë filmat që na pëlqejnë në dhomën e ndenjes, të errët, me televizorin në qendër, duke ngrënë kokoshka, si në kinema. Ndërsa kur dalim nga Parku i Liqenit ka paqe, nuk zihemi, shijojmë natyrën e herë-herë kujtojmë se sa bukur kalojmë me gjyshërit në Voskopojë. Bisedojmë për ditën në shkollë dhe tregojmë të gjitha sekretet e njëri-tjetrit.

Papritur kuptuam se do të bëhemi me një vëlla. Ardhja e tij në jetë bëri që ne ta donim më shumë njëri-tjetrin dhe kjo dashuri të rritej akoma më tepër për vëllain tonë të vogël, Henry.

Henry, një qenie e vogël, topolake e cila na bashkon sa herë jemi të trishtuar. Të dy ne ndjejmë një dashuri të pafundme për të, prandaj ai na qetëson, na gëzon sa herë që diçka nuk shkon. Zëri i tij melodioz dhe e qeshura e ëmbël, kur e përkëdhelim na çojnë në parajsë. Ne mundohemi t’ia plotësojmë të gjitha dëshirat se është më i vogël. Ai e pëlqen shumë futbollin, prandaj unë, Marko luaj çdo ditë me të, kurse unë, Rea bëhem portjere dhe disa herë i lë golat e Henrit pa kapur, me qëllim që ai të lumturohet jashtëzakonisht shumë.

Edhe pse kemi disa keqkuptime, gjithmonë jemi aty për ta mbështetur njëri-tjetrin. Nga thellësia e shpirtit uroj që kjo marrëdhënie të na shoqërojë gjithë jetën e të përmirësohet çdo ditë! Të kesh motër, të kesh vëlla është dhurata më e bukur që të bën **ZOTI !!!**

Rea dhe Marko Braksi

POEZI

10

Hëna — Sonja Shehu (kl. IX)

Hedh sytë nga qielli verdhosh,
Një pamje që të ndihmon të meditosh,
Vështroj diellin që tretet,
Një pikë e vogël në hapësirë mbetet.

E quajtura mbretëreshë qiellore,
Bijë e gjithësisë me bukuri përrallore,
Pak dritë jetësore lëshon,
Në kohën kur errësira famëkeqe pushton.

Vajza e nëna ndihmë të kanë kërkuar,
Fëmijët në ëndrra të kanë vizituar,
Ti gjithmonë u jep shpresë,
Në çastet kur kanë hasur një pengesë.

E dashur hënë, je shumë e çmuar,
Poezi të pafundme të janë kushtuar,
Si një medaljon në qiellin e zi,
Vazhdo shkëlqë ashtu si ti di.

Dallëndyshja dhe fëmija -- Dejav Agaraj

(kl. IX)

Ti mos u tremb moj dallëndyshe,
se qielli është i errët, gri.
Me ty dhe pranvera ka ardhur,
e dielli do të dalë përsëri.

Shkolla dhe shoqëria – Ertiona Peshku

(kl. IX)

Ja edhe një ditë tjetër,
Duke kaluar nëpër të njëjtën rrugë,
Për të kaluar edhe këtë herë, patjetër,
Një ditë me më të renë aventurë.

Kjo është shkolla ime,
Plot me kujtime stolisur,
Aty ku kam krijuar familjen time,
Që për nëntë vite më ka mirëpritur.

Këtu mësimet shoqërohen me përkushtim,
Bisedat dhe të qeshurat na shoqërojnë çdo orë,
Ndonjëherë bëhet edhe ndonjë gabim,
Por mësuesit me dedikim prindëror na ndihmojnë.

Më pas vijnë miqtë e mi,
Çdo ditë me biseda dhe batuta,
Dielli mbi kokë na rri si roje,
Kur kohën e lirë kalojmë përjashta.

Dhe ja, mbaroi edhe kjo ditë,
Koha për t'u rikthyer në shtëpi,
E di se e nesërmja më shpejt do të vijë,
Dhe do të më falë një tjetër ndodhi.

Për folenë që vjet ndërtove,
sa u kujdes ai fëmij'!
Ai që po të mbron me duar,
duke të dhënë shumë dashuri.

Shijojeni të dy pranverën,
ditët gri, ditët me shi.
Një dashuri si kjo e juaja,
nuk njih stinë, nuk njih kufij.

People, people, people — Erma Mici
(kl.VIII)

People, people, people
Can you solve this riddle?
They are senseless monsters
Who turned into feelings' hunters
Just to be fine with themselves
And not to care about anybody else
People, people, people
Some can play the fiddle
Eating souls for dinner
While everybody's a sinner
For them, nothing will matter
Whether calling me a "Mad Hatter"

Quoting "Never say Never"
But they're never better
Oh, please give me a cause
For you to take an applause
None of them will be decent
And that's their hymn for the weekend
Waking up overnight
I need to hold my heart tight
Got plenty of time to play
But, afterwards, I'll run away
People, people, people
Me's always in the middle,

Want to catch my breath?
Put me right to death
Now I ask "who is who"
Because I don't even know who are you
When all humans lie
That's my time to die
And in all places I wanna
I'll always listen to some piece of Nirvana

U lodha... -- Fabio Caka (kl.VI)

Duke kërkuar një buzëqeshje,
Duke pritur një përshëndetje,
Duke menduar një përqafim,
Dhe kudo gjej veç shtirje e përçmim.

O njerëz mos urreni,
Mos shani e përçmoni,
Mos shpifni e gjykoni,
Ju lutem, shpirtrat mos i lëndoni.

O njerëz,
Nga ju veç pak kërkoj,
Pak buzëqeshje, pak dashuri,
Pak sinqeritet e dhembshuri.

Lumturi — Klea Vrapì (kl. VI)

Zgjomë lumturi ime,
mos më lër të pres!
Bëhu vëlla me diellin
siç ndrit çdo mëngjes!

Mermë lumturi ime
rrymës a s'më çon?
Bëhu mik me lumin,
që kurrë nuk ndalon!

Fli, lumturi ime,
mos më lër pa gjumë!
Bëje motër Hënë,
yjet mban në gjunjë!
Eja lumturi ime,
më dëgjon? Ku je?

ARTI

Arti ka qënë, është dhe do të mbetet ushqimi shpirtëror i artistëve të vegjël, por të apasionuar, i talenteve që ka shkolla “Albanët”. Shkolla “Albanët” është një arenë në të cilën fëmijët e të gjitha moshave shpalosin aftësitë e tyre dhe ndër vite nga kjo shkollë kanë dalë talente të ndryshme. Aktivitetet në bazë klase organizohen në lëndë të ndryshme prandaj përfshihen forma të ndryshme prezantimi: me dramatizim, me pikturë, me këngë, me kërcim etj.



Kënga

Kjo magji e pashterrshme e gurrës popullore është bashkëudhëtare e përhershme në të gjitha aktivitetet e shkollës “Albanët”. Talentet e shkollës sonë kanë marrë pjesë dhe janë shquar për interpretimin dhe zërin e tyre melodioz, në aktivitetet që janë organizuar nga qendra të ndryshme për fëmijë, brenda dhe jashtë shkolle.



Kërcimi

Shkolla jonë i zhvillon të gjitha llojet e kërcimeve dhe kjo u jep mundësi të gjithëve që të performojnë atë që duan.



Koncerti i fundvitit

Në shkollën tonë organizohet gjithmonë *koncerti i fundvitit*. Nxënësit marrin pjesë në kërcime të ndryshme nga koreografi ynë **Gjergji Bajrami**.

Këngët janë të trajtuara nga profesor **Jetmir Mehmetaj**, kompozitor i këngëve dhe inçizohen në studion e tij nga zërat e fëmijëve tanë.

Gjithashtu një pjesë e veçantë e koncertit është ndarja e certifikatave për nxënësit më të mirë të vitit, me rezultate të shkëlqyera në mësim.



Dramatizimi

Nxënësit janë përsëri artist edhe jashtë shkollës në konkurse të ndryshme. Në konkursin e Fjalës Artistike, më 02.04.2018, dy nxënës të talentuar nga shkolla jonë: **Andra Kota** dhe **Fatjon Valteri** fituan çmimin e parë. Ata dramatizuan dhe recituan vargje për Heroin Kombëtar. Nga 100 fëmijë ata u përzgjedhën të 11 më të mirët. Ne ndihemi krenar me këta interpretues.



Piktura



Fëmijët relaksohen nga mësimet duke u shprehur në një pikturë. Në shkollën tonë neve na mundësojnë kohë të lirë për të shprehur talentin tonë. Zhvillohen shumë ekspozita për pikturat tona. Në datën 12.03.2018 në “Muzeun Kombëtar” u zhvillua ekspozita e pikturës “Edukimi nëpërmjet artit”.

Për realizimin e kësaj ekspozite ndihmuan me punimet e tyre të gjithë fëmijët që kishin talent në pikturë. Piktoret e vegjël jo vetëm u argëtuan, por kuptuan që piktura të edukon me ndjenjën e së bukurës, të mbush botën shpirtërore, të formon dhe të bën më të denjë për të ardhmen. Fëmijët u vlerësuan me çmime të ndryshme.




SHKENCË

“Shkenca e së sotmes është teknologjia e së ardhmes”, është një shprehje mjaft përparimtare nga Eduard Teller. Shkenca nuk është vetëm një mënyrë e të kuptuarit të mjedisit përreth. Ajo është rruga drejt së ardhmes, të cilën njerëzimi duhet ta ndjekë me një etje të veçantë për dije. Ajo përfaqëson natyrën njerëzore të eksplorimit, misterit, kureshtjes dhe zgjerimit drejt së panjohurës. Shkenca është rruga e vetme për njeriun drejt një të ardhmeje të sigurt dhe të ndritur. Në revistën tonë ne kemi shfaqur mjaft kuriozitete, shpikje dhe studime të reja shkencore që do t’ju lënë një përshtypje të veçantë.

ZBULIME NË FUSHËN E MJEKËSISË


1. Përdorimi i realitetit virtual dhe realitetit me elemente të shtuara në kirurgji.

Pavarësisht se realiteti virtual mund të duket një lojë e fjalës së fundit, ajo ka mjaft përdorime në mjekësi. Fakti që mund të simulohen mjedise 3D u bën të mundur kirurgjëve dhe mjekëve të kenë imazhe të plota 3D të trupit, organeve, por edhe i afroh më shumë me informacionet më të reja në lidhje me procedurën, si dhe është një mënyrë e mirë për trajnimin e mjekëve.



2. Imlantet kibernetike

Mund të duket fantashkencë, po këto implante janë mëse reale. Në fakt mund të gjenden në spitalet e sotme. Pajisje të tilla mund të jenë: nxitesi kardiak, i cili ndihmon zemrën në situata kritike, implanti koklear i cili u kthen dëgjimin personave dhe fëmijëve që nuk kanë dëgjuar ndonjëherë, zemra artificiale etj. Zakonisht këto vihen në organizëm me procedura kirurgjikale.



3. Neuroprotezat

Kjo lloj shpikjeje është zbatuar disa herë, por është edhe në perspektivë në të ardhmen. Procedura funksionon në këtë mënyrë:

Protezat robotike, siç janë krahët dhe këmbët robotike, lidhen me sistemin nervor të pacientit duke i mundësuar atij t'i kiontrollojë ato njësoj si gjymtyrët e veta.



Ekperimente të dobishme


Gatitja e baterisë në kushte shtëpie

Në shumë situata mund të nevojitet elektriciteti. Burim i rrymës janë bateritë. Ka një mënyrë për ta gatitur atë në kushte shtëpie.

Materialet e nevojshme janë: një kokërr limon, një monedhë zinku, një monedhë bakri, letër alumini.

Veprimi: Në një gjysmë kokërr limoni vihen monedhat në mënyrë të tillë që të depërtojnë lëkurën e tij. Me letër alumini lidhni në seri monedhat (dy të lidhura, dy jo të lidhura). Kjo do të rrisë tensionin dhe sasinë e rrymës elektrike. E lidhim me një llampë të vogël dhe vëmë re se ajo ndizet.

Arsyeja: Në mjedisin acid të limonit kemi bakër dhe zink. Meqënëse pjesa e brendshme e limonit është e ndarë me disa membrana, atëherë kemi elementin galvanic zink-bakër. Pra e thënë me fjalë të tjera kemi prodhim të energjisë elektrike nga energjia kimike.



SHKENCA BRENDA SHKOLLËS


Brenda shkollës sonë kemi zhvilluar aktivitete që kanë lidhje me shkencën. Aktivitete të tilla, si: dita e shkencës në të cilën nxënësit zhvillojnë projekte shkencore. Në këtë ditë nxënësit mund të krijojnë projekte dhe zhvillojnë eksperimente të ndryshme në lidhje me matematikën, fizikën, kiminë dhe informatikën ose mund t'i kombinojnë këto fusha së bashku. Në këtë ditë ka edhe një publik të cilit i presantohen projektet dhe eksperimentet. Kjo ditë është mjaft e veçantë dhe gjatë saj mund të mësosh për dukuri të ndryshme shkencore.



BIOGRAFIA

Dritëro Agolli

Dritëro Agolli është një nga ata që i ka dhënë emrin kohës dhe jo koha emrin atij. I cilësuar si një nga gjigandët e letërsisë shqiptarë bëri studimet në Rusi dhe vepra e tij e parë ishte “Në rrugë dolla” në 1958. Vepra e tij më me bujë është “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” e cila është përkthyer në 12 gjuhë të huaja.



Dritëro Agolli ka lindur në Devoll, në 13 tetor 1931 dhe e ka kryer gjimnazin në Gjirokastrë. Më pas vazhdoi Fakultetin e Arteve në Shën Petersburg, ku u martua për herë të parë gjatë kohës që ishte me studime. Pasi mbaroi studimet u bë gazetar te gazeta “Zëri i Popullit” dhe për 30 vjet ishte Kryetar i Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë.

Dritëro Agolli është fitues i katër çmimeve të Republikës dhe i disa çmimeve vjetore në Letërsi. Ai është anëtar i Akademisë së Firences “Muzat” në Itali. Përveç qytetit të Tiranës, ai është “Qytetar Nderi” edhe i qyteteve të Korçës, Gjirokastrës etj. Gjithashtu Dritëro Agolli ishte i shquar jo vetëm për romanet por edhe për dramën ku njëherë drama “I teti në bronz” është shfaqur edhe në Kinë, ku është pritur mjaft mirë nga publiku kinez. Gjithashtu Agolli është zgjedhur deputet për 30 vjet me radhë edhe në kohën e diktaturës, edhe dhjetë vjet në kohën e tranzicionit. Në Parlament mbahet mend për urtësinë dhe fjalimet brilante në podiumin Kuvendit. Në moshën 85 vjeçare ndahet nga jeta me një semundje kronike në mushkri por, ai do të mbetet një nga figurat më të shquara të penës shqiptare.




Veprat e tij me të cilat ai ka marrë çmime janë:

“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” roman i të cili është përkthyer në 12 gjuhë

“Poemë për babanë dhe për vete” poemë

“Devoll-Devoll” poemë

“Komisari Memo” dramë



**Vlerësimet e personaliteteve të huaj
Agollin**

për

“Agolli është Kafka, me pak më shumë diell” nga autori dhe gazetari francez **Francois Nourissier**

“Shqipëria na zbulon një autor me përmasa të mëdha... Dhe dinamiti mbulohet me petale. Një autor që meriton famë evropiane.” nga poeti i famshëm francez **Alen Boske**

Një shkrimtar duhet të ketë një ndërgjegje të lartë dhe nuk duhet të ketë frikë. Që të shkruash nuk do të thotë të pasqyrosh thjesht parimet e qeverisë. Duhet shkruar në një mënyrë të tillë që qeveria të mësojë të drejtë, të komandojë.” ka thënë për Agollin **Pierr Morrij**

Dritëro Agolli, Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, është gjithashtu një rast i veçantë, “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” është një satirë e tmerrshme ndaj të privilegjuarve të sistemit. Marrë nga Figaro Magazine shkruar nga publicisti **Robert Lacontre**.

SPORTI¹⁸



Lëndën e edukimit fizik e zhvillon mësuese Remina, profesor Elvis dhe profesor Maksim i cili na jep mësimet e shahut.

Në shah ka shumë nxënës të talentuar që kanë marrë çmime edhe jashtë shkollës sonë, si: Arbi Alliu (klasa IX) të Kampionatin Kombëtar të moshës 15-vjeç në Shqipëri.

Nga ana tjetër fizikultura organizohet në palestër ose në fushat e shkollës.

Të gjithë nxënësit vijnë me uniformën e rregullt: bluza e bardhë me tutat e zeza.

Ora mësimore duket sikur fluturon duke u ushtruar e duke luajtur volejboll, basketboll, futboll e shumë sporte të tjera.

Në disa periudha organizohen kampionate për sporte të ndryshme brenda shkollës, por edhe jashtë saj.

Gjithashtu shkolla jonë ka shumë nxënës të apasionuar pas sporteve dhe fitojnë çmime të ndryshme jashtë saj, si: Denis Guci (klasa IX) në Leipzig në Gjermani.





INTERVISTA

Profesor Gjergji Bajrami

Çfarë ju motivon që të jeni pjesë e stafit të shkollës ‘Albanët’?

Ja, këta janë motivimi im (fëmijët) dhe çdo ditë ne bëjmë diçka të re, ose më saktë çdo vit në çdo koncert, kemi diçka të re.

Tregoni për një arritje tuajën për të cilën jeni shumë krenar.

T’ju tregoj me foto? Jam shumë krenar për kërcimin e stinëve. Edhe për këtë kërcim (baleti), sepse kam arritur të bëj një balet të tërë për herë të parë në shkollën tonë dhe kam kapur personazhet, si: Prifti, princesha, Kuanzimodo.



Tregoni një rast kur keni kundërshtuar shefin tuaj.

Sa herë të më vij mua ta kundërshtoj, e kundërshtoj, sepse mua më duket mendimi im i drejtë dhe si gjithmonë është mendimi im.

Aleksios Gora - kl.VIII

Pse keni vendosur që të studioni në shkollën “Albanët”?

Normalisht, shtysa e parë erdhi nga prindërit e mi. Më pas, fillova të studioja një javë për ta provuar. Pashë që marrëdhënia midis mësuesit dhe nxënësve ishte e veçantë, dhe kjo më shtyu që të isha pjesë e kësaj shkolle.

Cili është mesuesi yt i preferuar dhe pse?

Mesuesi im i preferuar është profesor Koli, sepse shpjegon mirë dhe na jep informacion shtesë që do të na duhet në gjimnaz.

Cili mësues “flet më shumë” sigurisht, me qëllim të mirë?

Nuk është gjë e keqe, por Zysh Lili flet më shumë, sepse gjithmonë ka një gjë shtesë për të thënë dhe e ka me shumë pasion historinë.

Ish-nxënës Albanë:

Çfarë ju mungon më shumë nga shkolla “Albanët”?

Arkelino Hila: “Më merr malli për klasën time, një nga klasat më të mira që ka nxjerrë “Albanët”. Më merr malli për mësuesit dhe stafin, sepse ata kanë bërë të mundur që të jem në këtë vend që jam sot. Gjithashtu më merr malli për ushqimin e shkollës.”



Dorin Mane: “Më merr malli për ngrohtësinë dhe shoqërinë që gjeta tek “Albanët”.”

Omari Kuca: “Më merr malli për shoqërinë e pazëvendësueshme dhe mësuesit të cilët i përshëndes.”



EKSKURSION

Në shkollën tonë organizohen shumë ekskursionë në natyrë dhe në vende historike-arkeologjike ose social-kulturore. Neve na shoqërojnë mësuesit përkatës të lëndëve të cilët na iluminojnë rreth vendeve që vizitojmë . Përveç se argëtohemi ne gjithashtu mësojmë shumë kuriozitete të reja rreth historisë .

Transporti mundësohet nga furgonat e shkollës sonë. Ekskursionet zhvillohen në vende të ndryshme të Shqipërisë si: Berati, Pogradeci , Shkodra, Tropoja, Durrësi, Lezha etj.

Shkolla Albanët i zhvillon ekskursionet afërsisht 3-4 herë në vit .

Gjithashtu në shkollë organizohen dhe ekskursionë me fjetje. Nxënësit mezi i presin këto ekskursionë në të cilat relaksohen pas ditëve të gjata të ngarkuara me mësimë.



Klasa e VIII-të në një ekskursion në Shkodër.



Klasa IX në ekskursion.



ARGËTIM

Një ditë mësuesja vendosi të zgjidhte senatorin e klasës dhe pyet nxënësit:

- Ku shkoni çdo ditë pas shkolle?
- Unë blej cigare te Genci, - thotë i pari.
- Unë blej drogë te Genci, - thotë i dyti.
- Unë shkoj direkt në shtëpi, - thotë i treti.
- A, sa mirë, po si quhesh ti? – pyeti mësuesja.
- Unë jam Genci, - mësuese.

I thotë mamaja vajzës:

- Çohu të lash pjatat!
- Mami, unë kam lindur për gjëra të mëdha, -tha vajza.
- Ok. Çohu të lash tenxheret e tepsitë.

Në mëngjes nuk ha bukë, sepse mendoj për ty.

Në drekë nuk ha bukë, sepse mendoj për ty.


Në darkë nuk më zë gjumi, sepse më hahet bukë.

Doktori: -Hape gojën!

-Faleminderit doktor!

-Pse?

-Se të gjithë më thonë ta mbyll.



Redaksia

Grupi IV: Revista Albanët

Tiranë, më: 20.04.2018

Mësues:

1. Sanie Cufe
2. Edlira Kuca
3. Mirela Xara

Nx. Kl. VI:

1. Dea Ruçi
2. Iklea Çobo
3. Fabio Caka

Nx. Kl. VII:

1. Rea Braksi
2. Besea Buçpapaj

Nx. Kl. VIII:

1. Fatjon Valteri
2. Marko Braksi
3. Betina Koçi
4. Rashela Vrap
5. Klaris Gjikhuri

Nx. Kl. IX:

1. Andra Kota
2. Arbi Alliu
3. Denis Guci
4. Endri Haxhi
5. Jason Vasha

